



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 109, Datë 22.04.2021

MBI

**KËRKESËN E OSSH SH.A., LIDHUR ME VENDIMIN E ERE-S NR. 60, DATË
25.02.2021**

Në mbështetje të nenit 20, germa “ë”, nenit 81, pika 3, germa “ç”, nenit 94, pika 2, germa “b” dhe “ë” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 16, nenit 20, nenit 17, pika 1, germa “ë”, nenit 96, pika 11, nenit 98, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar; neneve 42, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 15 dhe 26 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”; “Rregulloren mbi Procedurat e Njoftimit dhe Konsultimit Publik të Akteve të Miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë” miratuar me vendimin nr.162 datë 20.10.2020 të Bordit të ERE; si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 22.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/4 prot., datë 20.04.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr.60, datë 25.02.2021”,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 218, datë 15.12.2020, bordi i ERE-s ka filluar procedurën për miratimin e Standardeve të Trajtimit të Ankesave të Klientëve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit.
- Përmes shkresës nr. 1315 prot., datë 30.12.2020, ERE ka kërkuar nga palët e interesit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesi i Shërbimit Universal, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Avokati i Popullit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Konsumatorit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të shprehnin opinionet dhe komentet e tyre mbi draft-Rregulloren brenda 30 ditëve nga marrja dijani.
- Rregullorja për të cilën bordi i ERE-s ka filluar procedurën është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE www.ere.gov.al, në zërin “Konsultime”, si dhe bërë me dije në Regjistrin e Vendimeve të ERE-s për vitin 2020, publikuar në zërin “Vendime”. Vendimi nr. 218/2020 është publikuar gjithashtu në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 08.01.2021.

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 2617/1 prot., datë 23.03.2021, protokolluar në ERE me nr. 435/1, datë 23.03.2021, ka paraqitur kërkesën për ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur në cilësinë e palës së interesuar lidhur me këto standarde, si dhe rishikimin e tyre nëse do të rezultojë e nevojshme duke konstatuar gjithashtu se si afektohet nga ky akt rregullator.
- Neni 54, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative parashikon se “...pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv”, ndërkohë që neni 55, pika 2 parashikon se “depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të shoqërisë OSSH sh.a., për përcjelljen e mendimeve apo objeksioneve në lidhje me Rregulloren e Standardeve të Trajtimit të Ankesave të Klientëve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit.
2. Pezullimin e zbatimit të afateve të parashikuara në vendimin e ERE nr. 60/2021 “Mbi miratimin e Standardeve të Trajtimit të Ankesave të Klientëve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit” për shoqërinë OSSH sh.a., për një periudhë 45 ditore nga marrja dijani e këtij vendimi.
3. Shoqëria OSSH sh.a., të përcjellë në ERE qëndrimin apo propozimet e saj për ndryshime në Rregulloren e Standardeve të Trajtimit të Ankesave të Klientëve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI